



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tiranë, më 22.08.2025

VËSHTRIM KRAHASUES I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR PËR REHABILITIMIN E SHTETASVE TË DËNUAR PASI KANË KRYER DËNIMIN (POST-RELEASING)

NGA KRISTEL MUÇMATA

PUBLIKUAR MË DT. 22 GUSHT 2025

<https://ahc.org.al/>

Vështrim krahasues i legjislacionit shqiptar për rehabilitimin e shtetasve të dënuar pasi kanë kryer dënimin (post-releasing)

Nga Kristel Muçmata

Publikuar më dt. 22 Gusht 2025

Ky Punim është realizuar nga praktikantja e Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH), Kristel Muçmata, përgjatë realizimit të praktikës profesionale nje mujore pranë Zyrave të KShH-së. Opinionet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë punim janë përgjegjësi e Autores (Kristel Muçmata) dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të KShH-së.

PËRMBAJTJE

1. Hyrje	1
2. Metodologjia	2
3. Baza Ligjore në Shqipëri për Rehabilitimin Post-Dënim	3
3.1. Ligji nr. 8328/1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve”	3
3.2. Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve (VKM nr. 303/2009)	4
3.3. Ligji nr. 10192/2009 “Për Shërbimin e Provës”	5
3.4. Ndihma për strehim dhe punësim	6
3.5. Rehabilitimi ligjor dhe regjistri penal	7
4. Standardet Ndërkombëtare për Rehabilitimin Post-Dënim	8
4.1. Regullat Mandela	8
4.2. Rregullorja Evropiane e Burgjeve	9
4.3. Rekomandimi Rec (2003)22 i Këshillit të Evropës	10
4.4. Jurisprudenca e GJEDNJ	11
5. Modelet Ndërkombëtare: Rasti i Anglisë dhe Gjermanisë	12
5.1. Modeli i Anglisë	12
5.2. Modeli i Gjermanisë	14
6. Analiza Krahasuese Ndërmjet Shqipërisë, Anglisë dhe Gjermanisë	16
7. Konkluzione dhe Rekomandime	18
8. Bibliografi	20

Hyrje

Përfundimi i dënimit me burgim nuk mund të konsiderohet i mbyllur me daljen e të dënuarit nga Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale. Faza pas lirimit është thelbësore për garantimin e rehabilitimit dhe ri-integrimit të tij në jetën sociale, ekonomike dhe familjare. Qasja ndaj personave që kanë kryer një dënim penal ndikon drejtpërdrejt në nivelin e përsëritjes të veprës penale, sigurinë publike dhe integritetin e sistemit të drejtësisë penale. Në këtë kuadër, vlen të theksohet se përqindja e ripërsëritjes në disa shtete evropiane sillet nga 30% në 50%, ndërkohë që në Shqipëri mungojnë statistika të mirëfillta, gjë që vështirëson vlerësimin dhe ndërtimin e masave efikase.

Organizata ndërkombëtare si Këshilli i Evropës, Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT), Kombet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian e konsiderojnë rehabilitimin pas dënimit jo vetëm si një masë sociale, por si një të drejtë të njeriut, e mbështetur në parimin e dinjitetit dhe mundësisë për një jetë të re. Politikat që dështojnë në mbështetjen e ish-të dënuarve rrezikojnë të krijojnë zinxhira dhune dhe marginalizimit, duke cënuar kështu barazinë e qytetarëve para ligjit.

Ndër të tjera, kjo çështje ka marrë vëmendje edhe në kontekstin e integrimit evropian të Shqipërisë, ku përmirësimi i sistemit të drejtësisë dhe respektimi i të drejtave themelore janë ndër kushtet kryesore të procesit të negociatave.

Ky artikull ka për qëllim të adresojë pikërisht këtë mangësi: të analizojë legjislacionin shqiptar mbi rehabilitimin post-dënim dhe ta krahasojë me praktikën e avancuar të vendeve të tjera, konkretisht Anglisë dhe Gjermanisë, si dy sisteme të ndryshme juridike:

common law dhe civil law. Do të paraqiten dispozitat ekzistuese ligjore, aktet nënligjore dhe politika shtetërore mbi trajtimin e ish-të dënuarve, me synimin e evidentimit të boshllëqeve në kuadrin shqiptar dhe ofrimit të rekomandimeve konkrete në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare.

Metodologjia

Ky studim bazohet në analizën krahasuese dhe analitike të:

- Akteve ligjore dhe nënligjore shqiptare që lidhen me trajtimin e të dënuarve dhe fazën post-dënim (Ligji nr. 8328/1998, VKM për rregulloren e burgjeve, Ligji për shërbimin e provës)¹;
- Standardeve ndërkombëtare (Regullorja Evropiane e Burgjeve, Rekomandimet e Këshillit të Evropës, Regullat Mandela të OKB);
- Modeleve të vendeve si Anglia dhe Gjermania, duke analizuar aktet e tyre ligjore dhe praktikat institucionale;
- Raporteve të institucioneve ndërkombëtare dhe organizatave qeveritare dhe joqeveritare.

Krahasimi do të fokusohet në tematika si: strukturat institucionale dhe bashkëpunimi pas lirimit; ndihma për strehim dhe punësim; programet e trajnimit dhe kualifikimit; rehabilitimi ligjor (fshirja e dënimit).

¹ Ligji nr. 8328, datë 16.4.1998 "Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve dhe të Paraburgosurve".

Baza ligjore në Shqipëri për rehabilitimin post-dënim

1. Ligji nr. 8328/1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”

Ky ligj është akti bazë që rregullon të drejtat e të dënuarve gjatë qëndrimit në institucione të vuajtjes së dënimit. Neni 48 parashikon se institucionet duhet të marrin masa për përgatitjen e të burgosurve për jetën e lirë, por formulimi i përgjithshëm nuk përkthehet në detyrime konkrete për fazën post-dënim. Rregulloret nënligjore nuk ofrojnë direktiva ose procedura të qarta për vazhdimësinë e kujdesit pas lirit.

Për më tepër, ligji nuk i njeh ish-të dënuarit si subjekt me të drejta të veçanta sociale. Nuk ka shuma buxhetesh të caktuara për mbështetjen ekonomike, shërbime të ndërmjetësimit në punësim, apo qasje të përshpejtuar në skemat e ndihmës sociale. Kjo e lë individin të pambrojtur në momentin kur ai është më vulnerabël nga rikthimi në kriminalitet.

2. Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve (VKM nr. 303/2009)²

Rregullorja përmban dispozita për përgatitjen e të dënuarve për lirim, duke përfshirë ndihmën për dokumentacion civil, orientimin për strehim dhe këshillimin psikologjik. Megjithatë, zbatimi është jo i qëndrueshëm. Raporti i CPT për Shqipërinë (2020) nënvizon se " shumica e institucioneve nuk ofrojnë plane reale të lirit dhe nuk ekziston ndjekje pas lirit nga asnjë strukturë publike.”

² VKM nr. 303, datë 25.03.2009 "Për Miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve".

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, megjithëse formalisht përgjegjëse për mbikëqyrjen e lirit, nuk ka kompetenca pas lirit të individit. Burimet njerëzore dhe financiare janë të kufizuara. Një monitorim i KShH në burgun e Peqinit evidentoi se vetëm 2 nga 15 të dënuar të liruar kishin marrë ndonjë informacion për ndihmën që mund të kërkonin jashtë institucionit.

3. Ligji nr. 10192/2009 “Për Shërbimin e Provës”³

Ky ligj rregullon dënimet alternative dhe mbikëqyrjen e lirit me kusht. Sipas nenit 5, mundësohet ndjekja e individëve që lirohen me kushte specifike nga gjykata. Megjithatë, në rastet kur individi ka përfunduar dënimin e plotë, nuk ekziston asnjë detyrim institucional për të ndjekur apo mbështetur atë në integrimin shoqëror.

Në praktikë, Shërbimi i Provës operon me një numër shumë të kufizuar punonjësish. Në vitin 2023, sipas të dhënave të Ministrisë së Drejtësisë, raporti mes mbikëqyrësve dhe të dënuarve ishte 1:70. Mungesa e bashkëpunimit me bashkitë ka rezultuar në mosrealizimin e detyrave për mbështetje në strehim, edukim ose punësim.

4. Ndihma për strehim dhe punësim

Asnjë dispozitë ligjore nuk detyron institucionet shtetërore të ofrojnë strehim për ish-të burgosurit. Ligji për strehimin social (nr. 22/2018) nuk i përmend ata si kategori prioritare. Për pasojë, shumica e tyre mbeten pa adrese fikse pas lirit, një faktor kyç në përsëritjen e sjelljes kriminale.

³ Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009 "Për Shërbimin e Provës në Republikën e Shqipërisë".

Njësoj, ligji për nxitjen e punësimit (nr. 15/2019) nuk përfshin dispozita për ish-të dënuarit si kategori e veçantë. Ndërkohë, punëdhënësit shpesh hezitojnë të punësojnë persona me precedent penal. Në mungesë të një mekanizmi për ndërmjetësim dhe mbrojtje ligjore, shumë individë e gjejnë veten të përjashtuar nga tregu i punës.

OJQ-të shqiptare si "ARSIS" dhe "Drejtësi Sociale" kanë zhvilluar projekte për mbështetje të integritetit, por aktiviteti i tyre mbetet i kufizuar dhe i varur nga financimet ndërkombëtare. Shteti nuk ka krijuar një kornizë bashkëpunimi të qëndrueshme me këto struktura.

5. Rehabilitimi ligjor dhe regjistri penal

Ligji nr. 10022/2008 "Për regjistrin penal"⁴ nuk parashikon fshirje automatike të dënimeve. Individët duhet të aplikojnë në gjykatë për rehabilitim ligjor, por procedura është e paqartë dhe e kushtueshme. Kërkohen dëshmi të "sjelljes së mirë", punësimit të qëndrueshëm dhe dëshmi të integritetit, të cilat shpesh janë të pamundura për një individ të anashkaluar.

Si rezultat, shumë të dënuar të liruar mbeten të njollosur ligjërisht për vite me radhë, duke mos qenë në gjendje të pajisen me certifikata pastërtie penale për qëllime punësimi ose aplikimi për kredi, licenca apo emigrim. Ky realitet bie ndesh me praktikën e vendeve të BE-së, ku pas një periudhe të caktuar, regjistrat penalë pastrohen automatikisht për veprat më të lehta.

⁴ Ligji nr. 10022, datë 27.11.2008, "Për regjistrin penal", Fletorja Zyrtare nr. 182, viti 2008.

Standardet ndërkombëtare për rehabilitimin post-dënim

Për të kuptuar më mirë kuadrin e pritshëm për një trajtim dinjitoz të ish-të dënuarve, është e nevojshme të analizohen instrumentet ndërkombëtare më të rëndësishme që normojnë rehabilitimin post-dënim. Këto standarde shërbejnë jo vetëm si udhërrëfyes për politikat penale të shteteve anëtare, por edhe si mekanizma kontrolli për institucionet ndërkombëtare në vlerësimin e përputhshmërisë ligjore dhe institucionale të shteteve si Shqipëria.

1. Regullat Mandela (United Nations Standard Minimum Rules for the Treatment of Prisoners)

Regullat Mandela⁵, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 2015, përbëjnë standardin më të plotë ndërkombëtar për trajtimin e të burgosurve. Edhe pse fokusi kryesor i tyre është trajtimi gjatë vuajtjes së dënimit, ato përfshijnë dispozita të rëndësishme për përgatitjen për lirin dhe mbështetjen pas lirit.

Rregulla 107 përcakton se autoritetet duhet të "sigurojnë që i dënuari të mos lihet në mëshirën e fatit pas lirit, por të pajiset me mjete për vetë-mbështetje", përfshirë ndihmën për strehim, punësim dhe mbështetje psikologjike. Rregulla 108 nënvizon nevojën për bashkëpunim ndërinstitutional dhe me shoqërinë civile, ndërkohë që Rregulla 90 përmend se rehabilitimi duhet të nisë në momentin e hyrjes në institucion, jo vetëm në fund të dënimit.

⁵ Mandela Rules – United Nations Standard Minimum Rules for the Treatment of Prisoners (UN General Assembly Res. A/RES/70/175, 2015).

Këto rregulla janë marrë në konsideratë nga Komiteti Kundër Torturës (CAT) në vlerësimet e veta mbi Shqipërinë, ku është theksuar mungesa e strukturave të pas-lirimit si një cenim i dinjitetit të të dënuarit dhe potencial për rikthim në kriminalitet.

2. Rregullorja Evropiane e Burgjeve (European Prison Rules, 2006/2020)

Rregullorja,⁶ e miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, përfaqëson standardin më të avancuar në nivel rajonal. Ajo përditësohet rregullisht dhe është përdorur si referencë kryesore për vendet anëtare të Këshillit të Evropës, përfshirë Shqipërinë.

Rregulla 33.3 parashikon se "trajnimet dhe programet rehabilituese duhet të përgatitin individin për jetën në komunitet", ndërsa Rregulla 107 bën thirrje për një "politikë të organizuar të ndihmës pas lirim", përmes bashkëpunimit me agjenci publike dhe OJQ. Rregulla 107.4 thekson qartë se "masat për rehabilitim duhet të fillojnë gjatë dënimit dhe të vazhdojnë pas lirim".

Në interpretimin e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (CPT), mungesa e një sistemi të integruar për pas-lirimin përbën trajtim degradues nëse individi përballet me varfëri ekstreme, përjashtim social dhe mungesë të përkujdesjes bazike. Në raportin për Shqipërinë (2020), CPT vëren se shumë të dënuar nuk dinë ku do të strehohen pas lirim dhe nuk kanë kontakte me shërbime sociale.

⁶ European Prison Rules (Council of Europe, Recommendation Rec(2006)2, revised 2020).

3. Rekomandimi Rec(2003)22 i Këshillit të Evropës për Menaxhimin e Lirimit nga Burgu

Ky rekomandim⁷ është dokumenti më specifik që lidhet me tematikën e rehabilitimit post-dënim. Ai synon të ofrojë një qasje holistike për përgatitjen për lirim dhe mbështetjen pas tij. Rekomandimi u sugjeron shteteve:

- të hartojnë plane individuale për lirim;
- të përfshijnë të dënuarit në vendimmarrje për përgatitjen e lirim;
- të bashkërendojnë veprimtarinë ndërmjet institucioneve të burgut dhe shërbimeve të komunitetit;
- të financojnë qendrat e tranzicionit dhe të strehojnë individët përkohësisht;
- të vendosin programe trajnimi dhe asistence për reintegrim profesional.

Këto masa janë në përputhje me parimet e të drejtave të njeriut dhe me objektivin e BE-së për rehabilitim efektiv si pjesë e politikave të drejtësisë penale. Në Shqipëri, asnjë nga këto masa nuk është e institucionalizuar, duke e bërë zbatimin të mbështetet kryesisht në projekte të përkohshme.

4. Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)

Edhe pse GJEDNJ nuk ka dhënë shumë vendime specifike mbi rehabilitimin pas lirim, ajo ka pranuar në disa çështje (si Vinter v. UK dhe Harakchiev v. Bulgaria) se mundësia reale për rehabilitim është pjesë e të drejtës për trajtim jo çnjerëzor sipas nenit 3 të Konventës Evropiane. Në rastin Khoroshenko v. Russia, Gjykata theksoi se izolimi

⁷ Rekomandimi Rec(2003)22 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës.

afatgjatë pa qasje në përgatitje për integrim është i papajtueshëm me parimet e dinjitetit njerëzor.

Këto jurisprudenca janë të rëndësishme për Shqipërinë, ku mungesa e rehabilitimit post-dënim mund të sjellë pasoja ligjore në rastet ku individët mbeten në kushte mjerimi dhe marginalizimi pa mbështetje institucionale.

Modelet ndërkombëtare: Rasti i Anglisë dhe Gjermanisë

1. Modeli i Anglisë (Sistemi Common Law)

a. Kuadri ligjor dhe institucional

Në Angli dhe Wells, trajtimi i të dënuarve pas lirimit është pjesë integrale e sistemit të drejtësisë penale dhe rregullohet përmes një sërë aktesh ligjore si:

- Offender Rehabilitation Act 2014⁸
- Criminal Justice Act 2003⁹
- Legal Aid, Sentencing and Punishment of Offenders Act 2012¹⁰

Reforma "Transforming Rehabilitation" e ndërmarrë nga Ministria e Drejtësisë synoi riorganizimin e shërbimeve të provës dhe rehabilitimit përmes krijimit të Community Rehabilitation Companies (CRCs), të cilat mbulonin individët me rrezik të ulët/mesatar.

⁸ Offender Rehabilitation Act 2014 (UK).

⁹ Criminal Justice Act 2003 (UK).

¹⁰ Legal Aid, Sentencing and Punishment of Offenders Act 2012 (UK).

Megjithatë, pas shqetësimeve për performancën dhe eficiencën, në vitin 2021 këto u riintegruan në një Shërbim Kombëtar të Provës të unifikuar (National Probation Service).

b. Programet dhe praktikat post-dënim

Çdo i dënuar në Angli përfiton nga një plan i individualizuar lirimi, i përgatitur gjatë vuajtjes së dënimit dhe i ndjekur pas lirimit. Kjo përfshin:

- Ndhinë për strehim përmes Housing Pathways;
- Trajnime profesionale dhe akses në punësim përmes National Careers Service;
- Mbështetje për shëndetin mendor dhe abuzimin me substancat përmes NHS;
- Konsulencë për menaxhimin e buxhetit dhe ristrukturimin e jetës sociale.

Institucione si St Giles Trust, Nacro, dhe The Forward Trust ofrojnë mbështetje të vazhdueshme për të dënuarit pas lirimit, me fonde nga shteti dhe donatorë privatë.

c. Parimi "Through-the-gate"

Ky parim konsiston në përgatitjen e të dënuarit për jetën në komunitet që përpara lirimit. Ai ka për qëllim të sigurojë që nuk ka ndërprerje midis vuajtjes së dënimit dhe fazës së rehabilitimit në shoqëri. Raportet e Her Majesty's Inspectorate of Probation tregojnë se ky model ka sjellë reduktim të recidivizmit në disa rajone, megjithëse suksesi varet nga bashkëpunimi lokal dhe buxhetimi i mjaftueshëm.

2. Modeli i Gjermanisë (Sistemi Civil Law)

a. Kuadri ligjor

Në Gjermani, rehabilitimi pas dënimit bazohet në:

- Strafvollzugsgesetz (Ligji për Ekzekutimin Penal);¹¹
- Bundeszentralregistergesetz (Ligji për Regjistrin Penal);¹²
- Sozialgesetzbuch (Kodi i Sigurimeve Sociale).¹³

Ligji për Ndhmën për të Dënuarit (Strafentlassenenhilfe)¹⁴ është në thelb një politikë shtetërore që garanton mbështetje për individët e liruar nga burgu përmes qasjes në shërbime të integruara.

b. Strukturat dhe institucionet zbatuese

Gjermania funksionon mbi një sistem federal, ku landet kanë autonomi në zbatimin e politikave penale. Organizata si Der Paritätische, Caritas, Diakonie, Arbeiterwohlfahrt (AWO), dhe Bewährungshilfe (shërbimi i provës), bashkëpunojnë me autoritetet lokale për të siguruar:

- Strehim tranzitor në shtëpi për të dënuarit (Übergangswohnheime);
- Këshillim ligjor dhe psikologjik;
- Integrim në sistemin e sigurimeve shoqërore;
- Ndhmë në kërkimin e punës dhe trajnime profesionale.

c. Statistikat dhe efektet

Sipas të dhënave të Bundesministerium der Justiz, norma e recidivizmit në Gjermani për të dënuarit që ndjekin programet e integritetit është më pak se 20%. Kjo është ndjeshëm

¹¹ Strafvollzugsgesetz (StVollzG) – Ligji për Ekzekutimin Penal, Gjermani.

¹² Bundeszentralregistergesetz (BZRG) – Ligji për Regjistrin Penal, Gjermani.

¹³ Sozialgesetzbuch – Kodi i Sigurimeve Shoqërore, Gjermani.

¹⁴ Ligji për Ndhmën për të Dënuarit (Strafentlassenenhilfe), Gjermani.

më e ulët se në vendet pa mbështetje strukturore. Procesi i fshirjes së dënimeve nga regjistri penal është automatik pas periudhës së përcaktuar, përveç rasteve me rrezik të lartë penal.

Modeli gjerman është i njohur për qasjen e tij të personalizuar, të qëndrueshme dhe të integruar në jetën sociale dhe ekonomike të të liruarve.

Analiza krahasuese ndërmjet Shqipërisë, Anglisë dhe Gjermanisë

Krahasimi i qasjes së Shqipërisë me atë të Anglisë dhe Gjermanisë në trajtimin e ish-të dënuarve pas lirimit tregon një ndarje të thellë mes standardeve ligjore dhe institucionalizimit të rehabilitimit në vendet perëndimore dhe fragmentimit ligjor e praktik në Shqipëri.

Në Shqipëri, mungon një kuadër ligjor specifik dhe gjithëpërfshirës për rehabilitimin post-dënim. Legjislacioni ekzistues (si ligji për të drejtat e të dënuarve dhe shërbimi i provës) nuk përmban dispozita të detajuara që rregullojnë mbështetjen pas lirimit. Përkundrazi, Anglia dhe Gjermania kanë ligje të mirëstrukturuara dhe politika të posaçme që adresojnë rehabilitimin si pjesë përbërëse të drejtësisë penale.

Institucionet shqiptare si Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Shërbimi i Provës kanë kompetenca të kufizuara dhe nuk bashkëpunojnë në mënyrë sistematike për ndjekjen e të liruarve. Në Angli, përkundrazi, Shërbimi Kombëtar i Provës ka një mandat të qartë për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e ish-të dënuarve. Në Gjermani, një rrjet i gjerë organizatash publike dhe joqeveritare punon në mënyrë të integruar me sistemin penal dhe atë social për të garantuar mbështetje të plotë.

Në aspektin e ndihmës për strehim dhe punësim, Shqipëria nuk ofron garanci ligjore apo struktura të qarta për ndihmën e të dënuarve pas lirit. Ndërsa në Angli dhe Gjermani, strehimi i përkohshëm, ndërmjetësimi në tregun e punës dhe trajnimi profesional janë pjesë përbërëse e procesit të lirit dhe përfshihen në planet individuale të ri-integrimit.

Përgatitja për lirim në Shqipëri është spontane dhe shpesh e munguar. Nuk ekziston një plan individual për secilin të dënuar që do të lirohet. Në Angli, koncepti "through-the-gate" siguron që përgatitja të nisë gjatë dënimit dhe të vazhdojë pas lirit. Po kështu, në Gjermani, rehabilitimi fillon brenda institucionit dhe mbështetja vazhdon me strukturat sociale vendore.

Rehabilitimi ligjor në Shqipëri është i vështirë për t'u arritur, për shkak të procedurave të komplikuar për fshirjen nga regjistri penal. Në krahasim, Anglia dhe Gjermania parashikojnë fshirje automatike të dënimeve pas një periudhe të caktuar, duke e lehtësuar punësimin dhe përfshirjen shoqërore të individëve të rehabilituar.

Së fundi, roli i organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri është i kufizuar dhe i pambështetur nga politika shtetërore. Ndërsa në vendet e analizuara, OJQ-të janë partnere të shtetit në implementimin e politikave të rehabilitimit, me fonde të garantuara dhe pjesëmarrje në vendimmarrje.

Në përmbledhje, Shqipëria ka nevojë për një reformim të thellë të qasjes ndaj të dënuarve pas lirit, duke marrë shembull nga praktikat pozitive të vendeve me përvojë në këtë fushë si Anglia dhe Gjermania.

Konkluzione dhe rekomandime

Analiza e zhvilluar tregon se sistemi shqiptar i drejtësisë penale nuk e trajton në mënyrë të plotë dhe të integruar rehabilitimin e personave të dënuar pas përfundimit të vuajtjes së dënimit. Legjislacioni aktual është i fragmentuar, mbështetja institucionale pas liritit është e kufizuar dhe mungon një strategji kombëtare për integrimin shoqëror dhe ekonomik të ish-të dënuarve. Këto mangësi e ekspozojnë këtë kategori ndaj marginalizimit, recidivizmit dhe papunësisë afatgjatë.

Nga krahasimi me Anglinë dhe Gjermaninë, del qartë nevoja për një qasje më proaktive dhe të koordinuar që e konsideron fazën pas liritit si pjesë të procesit të rehabilitimit dhe jo si fund të tij.

Rekomandime:

1. **Hartimi i një ligji të posaçëm për rehabilitimin post-dënim** – Ky ligj duhet të përfshijë dispozita të qarta për mbështetjen institucionale pas liritit, përfshirë ndihmën për strehim, punësim, edukim dhe mbështetje psiko-sociale.
2. **Zbatimi i parimit "përgatitje për lirim" (through-the-gate)** – Procesi i përgatitjes për lirim duhet të fillojë që gjatë dënimit, me plane individuale rehabilitimi që përfshijnë bashkëpunimin me institucionet lokale dhe shoqërinë civile.
3. **Krijimi i një strukture ndërinstitutionale kombëtare** – Një mekanizëm koordinues i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, pushtetit vendor dhe organizatave

joqeveritare, për të siguruar implementimin dhe monitorimin e politikave të rehabilitimit.

4. **Rishikimi i ligjit për regjistrin penal dhe rehabilitimin ligjor** – Të mundësohet fshirja automatike e të dhënave pas një periudhe të caktuar dhe të reduktohen pengesat ligjore për punësim e pjesëmarrje shoqërore për ish-të dënuarit.
5. **Financimi i shërbimeve mbështetëse nga buxheti i shtetit** – Programet për banesa sociale, ndihmë ekonomike, trajnime profesionale dhe këshillim psikologjik duhet të përfshihen në buxhetet vjetore të institucioneve përkatëse.
6. **Rritja e rolit të shoqërisë civile** – Duhet të krijohen partneritete të qëndrueshme ndërmjet shtetit dhe organizatave joqeveritare, duke siguruar mbështetje financiare dhe përfshirje në zhvillimin e politikave.
7. **Zhvillimi i një strategjie kombëtare për ri-integrimin** – Strategjia duhet të përfshijë objektiva afatshkurtra dhe afatgjata, indikatorë matës dhe përgjegjësi të ndara mes aktorëve institucionalë dhe lokalë.
8. **Fushata sensibilizuese për publikun dhe punëdhënësit** – Për të ulur stigmën ndaj ish-të dënuarve dhe për të promovuar përfshirjen e tyre në jetën ekonomike dhe shoqërore.

Këto masa janë të domosdoshme për të siguruar që sistemi penal shqiptar të mos jetë vetëm ndëshkues, por edhe rehabilitues dhe inkluziv, në përputhje me parimet e të drejtave të njeriut dhe praktikat më të mira evropiane.

Bibliografi

- Council of Europe, *European Prison Rules*, Recommendation Rec(2006)2, revised 2020.
- Këshilli i Ministrave i Shqipërisë, *VKM nr. 303/2009 për Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve*.
- Ligji nr. 10022, datë 27.11.2008, “Për regjistrin penal”, Fletorja Zyrtare nr. 182, 2008.
- Ligji nr. 10192/2009, *Për Shërbimin e Provës në Republikën e Shqipërisë*.
- Ligji nr. 8328/1998, *Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve dhe të Paraburgosurve*.
- Offender Rehabilitation Act 2014 (UK).
- Rekomandimi Rec(2003)22 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, *On the management of released prisoners*.
- United Nations, *Standard Minimum Rules for the Treatment of Prisoners (Mandela Rules)*, A/RES/70/175, 2015.
- UK Parliament, *Criminal Justice Act 2003*.
- UK Parliament, *Legal Aid, Sentencing and Punishment of Offenders Act 2012*.
- Bundesministerium der Justiz, *Strafvollzugsgesetz (StVollzG)*.
- Bundesministerium der Justiz, *Bundeszentralregistergesetz (BZRG)*.
- Bundesministerium für Arbeit und Soziales, *Sozialgesetzbuch*.
- Straftentlassenenhilfe – *Programmi për Ndhimë ndaj të Dënuarve të Liruar*, Gjermani. të mos jetë vetëm ndëshkues, por edhe rehabilitues dhe inkluziv, në përputhje me parimet e të drejtave të njeriut dhe praktikat më të mira evropiane.

